

# Raporti i Grupit Punues

## Fushata për mbledhjen e nënshkrimeve

### Synimet

1. Të mbliidhen një milion nënshkrime për të përkrahë themelimin e RECOM
2. Të përcohet porosia mbi rëndësinë e themelimit të RECOM tek sa më shumë njerëz që është e mundur

### Numri i nënshkrimeve për shtet

Fushata do të synojë mbledhjen e gjithsej një milion nënshkrimeve. Numri i nënshkrimeve për shtet do të ndahet si vijon. Do të mirren parasysh shtetet si Kroacia, Bosnia dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova, vende në të cilat është kryer një proces i gjithmbarshëm konsultativ dhe ku Koalicioni i RECOM është i fortë. Shtetet si Slovenia dhe Maqedonia nuk mund të marrin pjesë për shkak të një aktiviteti të dobët të koalicioneve vendore dhe mosekzistencës së procesit konsultativ.

Ndaj shifra prej një milioni do të ndahet mes këtyre pesë shteteve varësisht nga popullata përkatëse në këto shtete. 10,000 nënshkrime do të ndahen për Sloveninë dhe Maqedoninë së bashku (duke paraqitur kështu një rëndësi simbolike, jo aktuale). Një përlllogaritje e tillë do të rezultojë në këto shifra:

Sërbia:	390,000
Kroacia:	255,000
Bosnia dhe Hercegovina:	225,000
Kosova:	90,000
Mali i Zi:	30,000
Slovenia dhe Maqedonia:	10,000

### Mënyra e mbledhjes së nënshkrimeve

Në Sërbi dhe Kosovë ekziston një mënyrë formale e vëniës së draft-ligjit në agjendën e kuvendit përmes nismës civile. Kroacia propozon mundësinë e bindjes së kuvendit për të kërkuar zgjedhjet bazuar në nismën civile.

Në Sërbi, Kushtetuta parasheh mundësinë e një draft-ligji, rregulloreje apo një akti të përgjithshëm që duhet të propozohet nga jo më pak se 30,000 votues<sup>1</sup>. Kjo mundësi fuqizohet nga nisma e njerëzve, dhe është e rregulluar me dispozitat e Ligjit mbi Referendum dhe Nisma të Njerëzve<sup>2</sup>. Ky ligj i paraqet në mënyrë strikte mënyrat e mbedhjes së nënshkrimeve, përfshirë këtu edhe një afat prej shtatë ditësh, që duhet të raportohet në polici<sup>3</sup> dhe të qartësojë lokacionet specifike ku do të mbliidhen nënshkrimet<sup>4</sup>.

Kushtetuta e Kosovës parasheh një mundësi që jo më pak se 10,000 qytetarë mund të lansojnë një iniciativë për ratifikim të ligjit para Kuvendit të Kosovës<sup>5</sup>.

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Sërbisë, Neni 107, Paragrafi 1

<sup>2</sup> Ligji mbi Referendum dhe Nismë të Njerëzve, Gazeta Zyrtare e RS Nr. 48/1994 dhe 11/1998

<sup>3</sup> Ligji mbi Referendum dhe Nismë të Njerëzve, Neni 34, Paragrafi 3

<sup>4</sup> Ibid

<sup>5</sup> Kushtetuta e Kosovës, Neni 79

Kroacia parasheh një mundësi të mbledhjes së nënshkrimeve në mënyrë që të mund të thirret një referendum<sup>6</sup>. Megjithatë, procedura është e komplikuar dhe deri sot është dëshmuar e pasuksesshme (ngjashëm si në Sërbë, vendet dhe datat duhet të raportohen në polici, por ndahen 14 ditë për të mbledhur nënshkrimet e një minimum prej 10 përqind të elektoratit të përgjithshëm)<sup>7</sup>.

Është e dukshme që të gjitha normat legjislative janë jashtëzakonisht të komplikuar dhe të dizajnuara për të penguar nismën qytetare. Në të kundërtën, nëse RECOM themelohet përmes një marrëveshjeje ndër-qeveritare (si versioni më i mundshëm nga perspektiva ligjore), gjë që nuk mund të bëhet pa pajtimin paraprak të shteteve sa i përket vet marrëveshjes, e që duhet të vijohet më pas me ratifikimin në parlamentet kombëtare. Në këtë rast, **nuk ka vend për një nismë formale qytetare. Ndaj edhe mbledhja e nënshkrimeve në pajtim me ligjin në disa shtete përkatëse do të shpiente në komplikim të panevojshëm të mbarë procesit.**

Nënshkrimet duhet të mblidhen për qëllim të arritjes së synimeve të procesit, e jo për të përmbudhur ndonjë kërkesë formale kushtetuese apo ligjore.

Nënshkrimet do të mblidhen nga qytetarët që:

- Janë mbi moshën 18 vjeçare, dhe
- Janë, në momentin e nënshkrimit, qytetarët të shteteve të ish republikës së Jugosllavisë.

Për të sqaruar më tutje, qëllimi i gjithmbarshëm i fushatës është të mblidhen nënshkrime prej sa më shumë njerëzve që është e mundur. Kjo nënkupton që metoda e mbledhjes së nënshkrimeve është relevante. Në nivelet kombëtare do të mirren vendimet se si do të mblidhen nënshkrimet për grupet përkatëse. Grupi punues propozon metodat për mbledhjen e nënshkrimeve, si vijon:

- mbledhja e nënshkrimeve në standet gjatë fushatës gjashtë javore
- mbledhja e nënshkrimeve me metodën derë-më-derë, përmes aktivistëve
- mbledhja e nënshkrimeve përmes letrave postare, me ç'rast qytetarët mbushin formularët dhe i dërgojnë në adresat e përcaktuara
- mbledhja e nënshkrimeve përmes Internetit, me ç'rast qytetarët do të dorezojnë nënshkrimet, apo do të mbushin ndonjë sektor të veçantë interkativ në uebfaqe
- cilado metodë tjetër e shqyrtuar gjatë dizajnit apo zbatimit të fushatës

### **Formulari i nënshkrimit**

Formulari i nënshkrimit duhet të përmbajë kategoritë në vijim:

Obligative:

- Emri dhe mbiemri
- Adresa e banimit (rruga dhe numri, qyteti, komuna dhe shteti)
- Numri personal
- Nënshkruesi

Opcionale:

- telefoni kontaktues
- email adresa kontaktuese

---

<sup>6</sup> Ligji mbi Referendumin dhe Format tjera të Pjesëmarrjes Personale në Administratën e Shtetit dhe Vetqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare Nr. 33/96 dhe 92/01

<sup>7</sup> Ibid, Nenet 8b deri 8g

Formulari i nënshkrimit duhet të paraqes qartë dhe dukshëm qëllimin e mbledhjes së nënshkrimeve, cdo person që e nënshkruan petitionin duhet të lexojë titullin që thekson: ... me këtë nënshkrim unë e përkrrahë RECOM. Secili formularë duhet të ketë datën dhe numrin.

Formulari do të jetë i njëjtë në të gjitha shtetet (i njëjti person i dezignuar, të njëjtat informata) dhe në gjuhë të ndryshme në cdo shtet (dhe kjo vlen për të gjitha formularët: email, postare apo në letër). Secili shtet duhet të vendosë se në çfarë gjuhe dhe/apo alfabeti (latin, cirilik) do të jetë formulari. Poashtu, cdo shtet duhet të vendosë se sa kopje do të prodhohen për secilën gjuhë dhe/apo alfabet.

Edhe pse kjo nuk është një nismë formale dhe ndaj nuk do të verifikohet nga autoritetet përkatëse, ne mendojmë se informatat elementare (që mblidhen zakonisht dhe që shërbejnë si identifikime personale) duhet të mblidhen edhe në këtë rast. Numri personal identifikues e komplikon mbarë procedurën, sepse numrat ndryshojnë nëpër shtetet ku zbatohet fushata. Ndaj, numri personal do të përdoret për të identifikuar saktësisht personin i cili e nënshkruar petitionin.

Telefoni kontaktues dhe email adresa duhet të jenë në formulare, në një fushë zgjedhore. Disa njerëz nuk janë të gatshëm t'i shkruajnë, por është mirë t'i kemi në një bazë të dhënash dhe më vonë të organizojmë një aksion falënderimi me SMS/email apo t'i informojmë për rezultatin e nismës. Ata që duan të informohen më tutje, do të mbushin këtë pjesë. Njerëzit do të informohen për rezultatin e nismës në fund të procesit të mbledhjes së nënshkrimeve.

## **Mënyra e zbatimit të fushatës dhe struktura organizative**

### Vullnetarët dhe trajnerët

Për të mbledhur një milion nënshkrime, duhet të rekrutohen dhe trajnohen 2000 vullnetarë. Kjo shifër është arritur pas një vlerësimi që do të ishte e pamundur të pritet që një person mund të mbledh më shumë se 500 nënshkrime. Vullnetarët duhet fillimisht të trajnohen se si të përcojnë porosinë e rëndësisë së RECOM kur janë në kontakt me qytetarët. Poashtu, atyre duhet t'i ipen udhëzime të qarta për mënyrën e mbledhjes së nënshkrimeve, për atë se çfarë duhet të bëjnë me to, si dhe për detalet teknike dhe logjistike që janë esenciale për përmbushjen e një detyre aq komplekse.

Kjo kërkon implemetentimin e 100 trajnimeve (nga 200 vullnetarë për një trajnim). Këto trajnime duhet të mbahen nga trajnues të kualifikuar, të cilët janë trajnuar më parë dhe janë familjarizuar me synimet e RECOM. Kjo do të arrihet përmes trajnimit të trajnerëve, që duhet të jenë së paku 20 sosh. Pas trajnimit, trajnerët do të grupohen në qifte dhe cdo qift do të mbajë 10 trajnime të vullnetarëve. Trajnimi i trajnerëve do të organizohet për 30 persona, meqë është e arsyeshme të pritët se disa prej tyre do të tërhiqen për arsye të ndryshme apo do të jenë në pamundësi për të organizuar dhe implemetuar trajnimin e vullnetarëve. Trajnerët kanë vetëm një rol: të trajnojnë vullnetarët, dhe pasi që të bëhet kjo dhe pasi që fillon mbledhja e nënshkrimeve, ata nuk do të jenë më aktivë në fushatë si trajnerë. Ata mund të përfshihen më vonë apo të marrin ndonjë rol tjetër (sic përshkruhet më poshtë në sektorin e menaxhimit të Fushatës).

Mëditjet e vullnetarëve do të paguhën pasi që t'i mbledhin 500 nënshkrimet. Duhet të qartësohet se a do të paguhën shtesë për nënshkrimet e mbledhura. Edhe në qoftë se shumica e vullnetarëve vijnë në bazë vullnetare dhe të motivuar nga vlerat, është e nevojshme që të ndahen fonde për të siguruar suksesin e fushatës së mbledhjes së nënshkrimeve.

The volunteer per diems ëill be paid ëhen they collect 500 signatures. It should be consider if they ëould be paid extra for extra collected signatures. Even the majority of the volunteers ëill be gathered on the voluntary basis and value based interest, it is necessary that ëe put another insurance in order to the signature collection campaign succeed.

Nuk jam i sigurtë nëse e kam kuptuar këtë mirë. Por, unë mendoj se vullnetarët/ aktivistët duhet të paguhen pa marrë parasysh sa nënshkrime mbledhin (mendoj se mëditjet do të mbulojnë nevojat esenciale dhe megjithatë puna është masive). Ndoshta duhet të zbatohet edhe ndonjë sistem i shpërblimit (si motivim shtesë) kur numri i nënshkrimeve të mbledhura është shumë më i madh se 500. Por, sic thatë edhe vet, vullnetarët do të motivohen nga vlerat ndaj mendoj se nuk është në rregull që të kushtëzohet një sendviq dhe uhdëtimin më numrin e nënshkrimeve

Plotësisht pajtohem me komentin e Lanës- ata do të marrin mëditje e jo honorarë ndaj edhe nuk mund të kushtëzohen me numrin e nënshkrimeve.

Duhet të jemi shumë të ndjeshëm për këtë qështje. Mos të paguash vullnetarët që nuk kanë mbledhur 500 nënshkrime, qartë shprehë mosbesimin tonë. Shpërblimet si motivim shtesë janë gjë e mirë. Zgjedhja e duhur e vullnetarëve do të shmangë ...

Organizimi i trajnimeve dhe zbatimi i tyre bien nën juridiksionin e grupit koordinues për mbledhjen e nënshkrimeve.

#### Menaxhimi i Fushatës

Duhet të krijohet një strukturë e qartë e menaxhimit të fushatës për të qenë të vetëdijshëm për ndarjen precize të detyrave dhe përgjegjësi.

Grupi koordinues për mbledhjen e nënshkrimeve duhet të themelohet deri në Prill të vitit 2010. Ky grup koordinues duhet të emërohet nga trupi koordinues i RECOM. Ky grup koordinues do të përbëhet nga koordinatori regjional dhe 6 koordinatorë nacional (koordinatori regjional e mbulon edhe shtetin prej nga vjen). Koordinatori regjional do të menaxhojë me gjithë fushatës, i ndihmuar nga koordinatorët nacional. Koordinatorët nacional do të jenë përgjegjës për të gjitha aktivitetet e lidhura me fushatën në shtetet e tyre përkatëse dhe për koordinimin e futjes së të dhënave në bazën e të dhënave. Koordinatori regjional dhe ata nacional duhet të mbajnë kontakt ditor. Vartësit e tu7yre do të jenë koordinatorët territorial (rrethit, regjionit... varësisht nga terminologjia lokale), dhe do të kenë për detyrë disa komuna apo qytete, ku ata do të organizojnë rrjetet e vullnetarëve, do të mbikëqyrin punën e ekipeve të vullnetarëve, do të verifikojnë rezultatet në fund të ditës dhe do të japin rekomandime/propozime Koordinatorëve Nacional rreth ndryshimeve potenciale në metodologjinë e mbledhjes së nënshkrimeve. Numri i tyre, zona e juridiksionit, dhe numri i vullnetarëve në dispozicion do të varet nga popullata e zonës përkatëse, rrethanat gjeografike dhe infrastrukturave dhe fuqia e rrjetit të Koalicionit të RECOM në atë zonë. Këto koordinatorë nuk do të thotë që duhet të vijnë nga zonat në të cilat kanë juridiksion, meqë mund të gjinden persona kompetent ndoshta nga një zonë tjetër. Menaxhimi i fushatës duhet të bëhet para trajnimit të trajnerëve.

#### Aktivitetet e ndërlidhura me fushatën

Një numër i vullnetarëve të angazhuar do të jenë përgjegjës në zyren qendrore për monitorimin e mbledhjes së nënshkrimeve elektronike përmes internetit. Ata do të shkarkojnë nënshkrimet nga uebfaqja dhe do t;i fusin në bazën e të dhënave. Secili shtet (apo Zyre Nationale) do të ketë një ekip që

do të mirret me nënshkrimet që vijnë me letra postare, dhe do të kenë për detyrë t'i dorëzojnë ato tek personat përgjegjës për plotësimin e bazës së të dhënave.

Vullnetarët do të mbledhin nënshkrime në shtange, rreth 500 sosh që do të vendosen, dhe nëpër aktivitetet derë-më-derë. Të gjithë vullnetarët duhet të marrin pjesë në të dyja format e mbledhjes së nënshkrimeve. Të gjitha nënshkrimet elektronike do të dorëzohen në bazën nacionale në fund të secilës ditë pune. Aty ato do të futen në bazën qendrore të të dhënave elektronike. Format në letër duhet t'i dorëzohen koordinatorëve nacional pasë cdo 100 nënshkrimeve të mbledhura.

#### Baza e të dhënave

Do të jetë një bazë e vetme e të dhënave për mbarë regjionin. Ajo do të gjindet në internet, e mbrojtur me masat përkatëse të sigurisë (një server special i vendosur jashtë shteteve). Koordinatori Regjional, koordinatorët nacional dhe administratorët e futjes së të dhënave do të kenë casje në bazën e të dhënave dhe ata duhet të jenë individë të besueshëm. Numri i tyre duhet të jetë i kufizuar (maksimum 10 për një shtet). Ata do të punojnë me ndërrime, që do të koordinohen nga koordinatorët nacional. Forma e bazës elektronike të të dhënave është e nevojshme për të pasë një pasqyrë se si po përparon fushata. Poashtu është e nevojshme të ruhen formularët e letrës për...

#### **Struktura e trajnerëve dhe vullnetarëve për shtet**

Gjithsej 30 trajnerë që marrin pjesë në trajnim do të grupohen në 15 qifte:

Serbia: 4 qifte (8 trajnerë)  
Kroacia: 3 qifte (6 trajnerë)  
B&H: 3 qifte (6 trajnerë)  
Kosova: 2 qifte (4 trajnerë)  
Mali i zi: 1 qift (2 trajnerë)  
Maqedonia: 1 qifte (2 trajnerë)  
Slovenia: 1 qift (2 trajnerë)

Nën këto rrethana, disa shtete do të kenë më shumë trajnerë se që është e nevojshme, por qëllimi është që cdo shtet të ketë së paku një qift trajnues. Meqë ka gjasa që disa nga këta trajnerë të tërhiqen (siq është shpjeguar më lartë), do të ketë mundësi që trajnerët nga shtete tjera të ndihmojnë dhe në këtë mënyrë të përmbyllen të gjitha trajnimet e vullnetarëve.

Me të njëjtën metodë sikurse për numrin e nënshkrimeve, totali i 2,000 vullnetarëve do të ndahet si vijon:

Serbia:	810
Kroacia:	480
B&H:	430
Kosova:	190
Mali i Zi:	70
Maqedonia:	10
Slovenia:	10

Do të ishte ideale që shtet që janë të pajisura me kapacitetet adekuate të rekrutojnë vullnetarë shtesë, në mënyrë që t'u shmangemi problemeve që mund të dalin nëse dikush largohet në mes të fushatës apo

ndonjë vullnetarë ka mosmundësi objektive të përmbush obligimet. Poashtu, vullnetarët që punojnë në zyret nacionale të mos përfshihen në këto numërime.

### Harta e mbulimit

Duhet të hartohet një hartë fillestare e mbulimit para rekrutimit të vullnetarëve dhe vendosjes së tërë rrjetit. Kjo hartë duhet të përmbajë një numër të projektuar të nënshkrimeve që duhet të mbidhen në një zonë të caktuar (grup komunash apo qytetesh), kapacitetet ekzistuese të Koalicionit në atë zonë, cfarë rrjetesh apo shoqatash mund t'i gjejmë në atë zonë specifike, a eksiton mundësia e rekrutimit të partive politike, degës së rinisë në zona përkatëse, etj.

Kjo hartë do të shërbente si pikë fillestare për themelimin e ardhshëm të rrjetit dhe ekipeve të vullnetarë për zonën përkatëse. Harta poashtu duhet të paraqes vendet ku duhet bërë përpjekje më të mëdha për rekrutimin e vullnetarëve, dhe të paraqesë grupet me të cilat duhet të negociohet për t'i përfshirë edhe ata në proces.

Duhet të organizohet dhe shpërndahet një pyetësorë në rrejtin e organizatave të RECOM mbi kapacitetin dhe vullnetin për të marrë pjesë në këtë fushatë. Pyetësori është esencial në mënyrë që të arrijmë një planifikim më të mirë dhe efikasitet të kapmanjës.

### Orari i Fushatës

Fushata për mbledhjen e nënshkrimeve bëhet paralelisht me fushatën mediale. Duhet të bëhet një vetëdijësim paraprak i qytetarëve për mbledhjen e nënshkrimeve dhe RECOM-in.

- Grupi për mbledhjen e nënshkrimeve (Koordinatorët Rregjional dhe Nacional): Të krijohet në Prill 2010
- Harta e mbulimit: Të hartohet në Maj 2010
- Trajnerët për trajnimet: Të rekrutohe në Korrik 2010.
- Trajnimi i trajnerëve: Gusht 2010.
- Rrjeti i vullnetarëve, përfshirë edhe koordinatorët lokal: Të themelohet deri në Dhjetor 2010
- Trajnimi i vullnetarëve: Të implementohet në Janar dhe Shkurt 2011.
- Mbledhja e nënshkrimeve: 15 Mars deri më 1 Maj 2011
- Dorëzimi i nënshkrimeve: 1 Qershor 2011

Muaji/ Aktiviteti	04/ 10	05/ 10	06/ 10	07/ 10	08/ 10	09/ 10	10/ 10	11/ 10	12/ 10	01/ 11	02/ 11	03/ 11	04/ 11	05/ 11	06/ 11
<b>Grupi për mbledhjen e nënshkrimeve</b>	X														
<b>Harta e mbulimit</b>		X													
<b>Trajnimi i Trajnerëve (Rekrutimi)</b>			X	X											
<b>Trajnimi i trajnerëve</b>					X										
<b>Rrjeti i vullnetarëve/</b>						X	X	X	X						

<b>Koordinatorët lokal</b>															
<b>Trajnimi i Vullnetarëve</b>										X	X				
<b>Mbledhja e nënshkrimeve</b>												X	X		
<b>Dorëzimi i nënshkrimeve</b>															X

**Kapacitetet e Koalicionit**